REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
25-04-2016
02-013/508

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipallity of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/2008 dhe nenit 51, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë bien këtë:

# VENDIM

## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 4.698,70 € PËR PAGIMIN E ANËTARËSISË NË ASOCIACIONIN E KOMUNAVE TË KOSOVËS PËR VITIN 2016

I.

Me këtë vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë, ndan mjetet financiare në shumë prej 4.698,70€ ( katërmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë euro e 70 cent) për pagimin e anëtarësisë në Asociacionin e komunave të Kosovës për vitin 2016.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në llogari të Asociacionit të komunave të Kosovës.

II.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2016 nga kodi për mallra dhe shërbime Drejtorisë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim të Komunës së Vitisë.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e thesarit e Komunës së Vitisë.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

02. Nr. 013/_______
Viti, 22.04. 2016

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti